

VENDIM
Nr. 271, datë 12.5.2021

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 275, DATË 1.4.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR
KUSHTET DHE RREGULLAT E SIGURISË SË ARMËVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 3, 17, pika 4 dhe 28, pika 4, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin e rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 275, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, të nenit 1, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në shkronjën “b”, pas fjalës “... pjesëve...” shtohet “... kryesore...”.

b) Në shkronjën “c”, pas fjalës “... armëve ...” shtohen fjalët “... pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre ...”.

c) Në shkronjën “ç”, pas fjalës “... civil ...” shtohen fjalët “... të hapur, të mbyllur dhe me pjatel ...”.

2. Në nenin 5 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë si vijon:

“Kushtet e përgjithshme për ruajtjen e armëve të zjarrit, pjesëve kryesore dhe municionit të tyre bazohen e variojnë sipas numrit të armëve të zjarrit të lejuara për mbajtje, pjesëve kryesore dhe sasisë së municioneve të tyre, sipas kësaj ndarjeje:”.

b) Në shkronjën “d”, pas fjalëve “... tregtimin e armëve ...” shtohen “ ... pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre të kategorisë “C” dhe “D”;”.

3. Neni 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 11

Transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre mund ta bëjë çdo person fizik dhe juridik me seli në Republikën e Shqipërisë, që është licencuar nga Policia e Shtetit për këtë qëllim.”.

4. Paragrafi i parë, i nenit 12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Subjektet e licencuara për transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municionit të tyre duhet të plotësojnë këto kushte:...”.

5. Në nenin 15 bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Kudo në tekstin e nenit, pas fjalës “... poligon ...” shtohet fjala “... civil ...”.

b) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) poligon civil qitjeje me pjatel.”.

c) Pas pikës b.1 shtohet pika c.1 me këtë përmbajtje:

“c.1. Poligon civil qitjeje me pjatel është pjesë terreni (territori) e përzgjedhur dhe e përgatitur sipas kriterëve standarde për zhvillimin e qitjeve me armët e gjahut.”.

6. Në nenin 16 shtohen shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, me këtë përmbajtje:

“d) Ambienti të jetë me kushte të tilla që të garantojë që predhat/saçmat të mos bien në lumenj, rezervate apo liqene;

dh) Të respektojë standardet për mbrojtjen nga ndotja akustike;

e) Të disponohet leje nga autoriteti shtetëror përkatës ku do të ndërtohet poligoni civil i hapur.”.

7. Pas nenit 16 shtohet neni 16/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 16/1

Rregullat e ndërtimit dhe shfrytëzimit të poligonit civil me pjatel

Poligoni civil i ndërtuar në natyrë duhet të plotësojë këto kushte:

a) Të jetë larg qendrave të banuara dhe drejtimi i qitjes me pjatel të jetë në drejtim të kundërt me banesat;

b) Në drejtim të qitjes, poligoni sigurohet në më shumë se 200 m në vijë ajrore dhe 100 m në të dyja krahët në këndin 90 gradë me drejtimin e qitjes;

c) Ambienti të jetë me kushte të tilla që të garantojë që saçmat të mos bien në lumenj, rezervate apo liqene;

ç) Të respektojë standardet për mbrojtjen nga ndotja akustike;

d) Të disponohet leje nga autoriteti shtetëror përkatës, ku do të ndërtohet poligoni me pjatel;

dh) Të ketë kushte të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve që krijohen gjatë qitjes apo gjatë shërbimeve të tjera që ofrohen në poligon, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.”.

8. Në nenin 17 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Ndarjet e ambienteve në poligonet e qitjes.

Çdo poligon civil ka:

i. dhomën e regjistrimit të mbrojtur me xham antiplumb;

ii. dhomën e komandës nga e cila monitorohen veprimet gjatë zhvillimit të qitjes;

iii. dy ose më shumë korsi të qitjes.”.

b) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Lartësia e poligonit: jo më pak se 280 cm;”.

9. Në nenin 23 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Paragrafi i parë dhe shkronja “a” e nenit 23 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Objekti që shërben për tregtimin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre nga brenda duhet të pajiset me:

a) kasaforta të sigurt sipas sasisë së armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, si në rastet e përcaktuara në këtë rregullore për armët e zjarrit.”.

b) Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) të ketë kushte të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve që krijohen gjatë shërbimeve që ofrohen në objekt, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.”.

II. Ngarkohet Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, të kërkojë e të mbikëqyrë zbatimin e rregullave e të procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe